

VENDIM
Nr. 325, datë 31.5.2023

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

(Ndryshuar me VKM-në nr. 621, datë 1.11.2023; nr. 793, datë 28.12.2023; nr. 281, datë 8.5.2024; nr. 421, datë 26.6.2024, nr. 485, datë 24.7.2024; nr. 502, datë 1.8.2024; nr. 864, datë 30.12.2024; nr. 25, datë 10.1.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”; të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen zëvendësministrat, funksionarët e kabineteve, prefekti, nënprefekti, nëpunësit civilë dhe nëpunësit (subjekte përfituese) në institucionet, si më poshtë vijon:

a) Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, administratën e Kuvendit, administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoritetin e Konkurrencës, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Entin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Institutin për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Komisionerin e Mbrojtjes nga Diskriminimi, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, Gjykatën e Lartë, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Komisionin e Prokurimit Publik, Institutin e Statistikave, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, administratën e Shkollës së Magjistraturës, Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë;

b) Institucionet qendrore të grupit të parë, ku bëjnë pjesë: Departamenti i Administratës Publike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, *Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike*, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencia për Media dhe Informim, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Avokatura e Shtetit, *Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës*;

c) Institucionet qendrore të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë: Agjencia Telegrafike Shqiptare, Inspektorati Qendror, Komiteti për Pakicat Kombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të

Shtetit, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, *Agjencia e Inteligjencës Financiare*, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, *Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthjera*, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, *Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it*, *Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes*;

ç) Institucionet qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë: Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, Komiteti Shtetëror i Kulteve, *Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit*, Agjencia Kombëtare e Diasporës, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, *Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar*, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Instituti i Shëndetit Publik, Drejtoria e Përgjithshme Detare, *Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve*, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, Autoriteti Rregullator Hekurudhor, Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve, Incidenteve Hekurudhore dhe Detare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësim, Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (*EIT Raw Materials Regional Innovation Centre*), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, *Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes*, Drejtoria e Shifrës, Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit, Qendra e Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve;

d) Institucionet qendrore të grupit të katërt, ku bëjnë pjesë: Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar, *Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve*, Agjencia Kombëtare e Rinisë, administrata e prefektit, Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Sistemit të Ministrisë së Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, Qendra e Pritjes për Azil, Shtëpia e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, Qendra e Botimeve Zyrtare, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Agjencia Kombëtare e Falimentimit, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Agjencia e Shërbimeve të Sportit Tiranë, qendrat e

transferimit të teknologjive bujqësore, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, Instituti i Studimeve të Transportit, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, Sekretariati Kombëtar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI-Shqipëri), Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Drejtoria e Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Çirku Kombëtar, Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi”, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit Sarandë, zyrat e administrimit dhe koordinimit të parqeve arkeologjike, Qendra Muzeore Krujë – Muzeu Kombëtar “Skënderbeu”- Muzeu Etnografik Krujë, Qendra Muzeore Berat – Muzeu i Ikonografisë “Onufri”, Muzeu Etnografik Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Qendra Muzeore Durrës, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Komanda dhe Shtabi i Forcës Tokësore, Komanda dhe Shtabi i Forcës Detare/Rojës Bregdetare, Komanda dhe Shtabi i Forcës Ajrore, Komanda dhe Shtabi i Komandës Mbështetëse, Qendra e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Instituti Kërkimor-Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Arsimit Profesional të Ushtarit, në Akademinë e Forcave të Armatosura, Qendra e Riparimit dhe Mirëmbajtjes së Teknikës së Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse, Sektori i Helikopterëve i Repartit Special RENE, shtëpitë e pushimit të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Bashkuar Operacionale e Forcave të Armatosura, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake, Batalioni i Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, batalionet/kompanitë/qendrat stërvitore në Forcën Tokësore, distriktet detare/flotiljet detare/Shërbimi Hidrografik/Qendra e Vëzhgimit Detar/Qendra e Zhytjeve/Qendra Stërvitore/kompanitë mbështetëse në Forcën Detare, Baza Ajrore/Shërbimi Meteorologjik Ushtarak/Qendra e Kontroll-Raportimit/Qendra Stërvitore/Kompani në Forcën Ajrore, Batalion/Kompani/Qendra Stërvitore në Komandën Mbështetëse, Kompani/Qendra në Akademinë e Forcave të Armatosura; *Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, Administrata (specialist) në qendrat burimore dhe shkollat me status të veçantë.*

dh) Degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, të kësaj pike dhe Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”.

2. Në kuptim të këtij vendimi:

a) Njësitë organizative të përmbajtjes, drejtoritë e përgjithshme të përmbajtjes, drejtoritë e përmbajtjes apo sektorët e përmbajtjes janë ata/ato që realizojnë funksionet për të cilat është krijuar dhe funksionon institucioni. Në to nuk përfshihen strukturat organizative përgjegjëse për funksionet horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;

b) Njësitë organizative mbështetëse, drejtoritë e përgjithshme mbështetëse, drejtoritë mbështetëse, sektorët mbështetës apo specialistët mbështetës janë ato/ata që kryejnë funksionet

horizontale të institucionit, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

II. KATEGORITË, KLASAT DHE ELEMENTET PËRBËRËSE TË PAGËS BRUTO MUJORE

1. Kategoritë, klasat e pozicioneve të punës, elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element të tyre për funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, me përjashtim të nëpunësve të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, janë, si më poshtë vijon:

a) Kategoritë dhe klasat e pozicioneve të punës përcaktohen në kolonat 1 dhe 2, të lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune, është sipas kolonës 3, të lidhjes nr. 1;

c) Shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, përcaktohet në kolonën 4, të lidhjes nr. 1 dhe në lidhjet përkatëse të këtij vendimi. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

ç) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

d) Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

dh) Shtesa për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin.

Klasat e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së secilit institucion.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore janë, si më poshtë vijon:

a) Për funksionarët në pozicionet zëvendësministër, prefekt, nënprefekt, këshilltar i Prefektit të Qarkut Tiranë dhe zëdhënës i Prefektit të Qarkut Tiranë, paga bazë mujore e pozicionit të punës;

b) Për nëpunësit kërkimorë-shkencorë të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, paga bazë mujore e pozicionit të punës, e përcaktuar sipas titullit akademik apo gradës shkencore.;

c) Për nëpunësit e trupës artistike në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, trupës artistike në Teatrin Kombëtar, trupës artistike në Teatrin e Kukullave në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, trupës artistike në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, trupës artistike në Cirkun Kombëtar, trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medies dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe trupës artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura:

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu;

iii. shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

ç) Për nëpunësit e sektorit të helikopterëve në Repartin Special RENE:

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu;

iii. shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune);

d) Për nëpunësit në pozicionet “sekretar”:

i. paga bazë mujore e pozicionit të punës;

ii. vjetërsia në punë që llogaritet mbi pagën bazë mujore të pozicionit të punës, sipas përqindjeve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu;

dh) *shfuqizuar*

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

4. Masa e shtesës për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për disa nga funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, në masën dhe sipas rregullave e kritereve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e përcaktuar në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

III. KLASAT DHE NIVELET E PAGAVE E TË PAGESAVE TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE

1. Klasat e pagave për funksionarët e kabineteve të institucioneve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, dhe vlera e pagës bazë mujore për pozicionet “zëvendësministër”, “prefekt”, “nënprefekt” dhe “sekretar” janë sipas përcaktimit në lidhjen nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Presidenti i Republikës, *Kryetari i Kuvendit*, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat apo titullarët e institucioneve në varësi të tyre, me qëllim realizimin me efektivitet dhe eficiencë të misionit dhe objektivave të institucionit, që drejojnë, kanë të drejtë që, për të marrë këshillimin e duhur për çështje specifike, të kenë këshilltarë të jashtëm apo ndihmës të jashtëm. Pagesa e këshilltarëve të jashtëm dhe ndihmësve të jashtëm bëhet nga llogaria ekonomike e përcaktuar sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat dhe përcaktohet nga:

a) Presidenti, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj;

b) Kryeministri, për këshilltarët e jashtëm dhe ndihmësit e jashtëm, të emëruar prej tij, në masën përkatësisht deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj për këshilltarët e jashtëm dhe deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj për ndihmësit e jashtëm;

c) Zëvendëskryeministri dhe ministrat, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj;

ç) Titullarët e institucioneve në varësi të Kryeministrit apo ministrave, për këshilltarët e jashtëm, të emëruar prej tyre, në masën deri në 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.

d) *Kryetari i Kuvendit, për këshilltarët e jashtëm të emëruar prej tij, në masën deri në 130 000 (njëqind e tridhjetë mijë) lekë në muaj.*

3. Përjashtimisht, Kryeministri ka të drejtë të angazhojë si këshilltarë të jashtëm edhe shtetas të huaj, ekspertë/konsulentë të njohur ndërkombëtarisht, me një pagesë jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë në muaj, për një periudhë angazhimi jo më shumë sesa kohëzgjatja e mandatit të tij.

4. shfuqizuar

5. Klasat e pagave për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në institucionet e përcaktuara në pikën 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë/nëpunësve në institucionet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/1. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, si dhe nëpunësve civilë të prokurorisë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të

përgjithshëm janë sipas lidhjes nr. 7/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/2. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr. 7/2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr. 7/2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/3. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë sipas lidhjes nr. 7/3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë sipas lidhjes nr. 7/3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/4. Klasat dhe nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 7/4/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë sipas lidhjes nr. 7/4/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6/5. Klasat e pagave për pozicionet e punës në Shkollën e Magjistraturës janë sipas lidhjes nr. 7/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë sipas lidhjes nr. 8/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor janë sipas lidhjes nr. 8/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7/3. Klasat e pagave për pozicionet e punës në administratën e Avokaturës së Shtetit janë sipas lidhjes nr. 8/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësi i emëruar jashtë vendit në pozicionin “Jurist pranë Misionit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Evropës, i cili është përfaqësues i përhershëm pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ka statusin financiar të përfaqësuesit të ministrisë së linjës në përfaqësinë tonë diplomatike pranë BE-së.

7/4. *Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert”, “drejtues qendre”, “zëvendëstitullar institucioni” dhe “titullar institucioni” në Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës janë sipas lidhjes nr. 8/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

8. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Inspektoratin Qendror janë sipas lidhjes nr. 9/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë e

Inteligjencës Financiare janë sipas lidhjes nr. 9/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/3. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit doganor janë sipas lidhjes nr. 9/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Nëpunësit/punonjësit e kategorizuar në kategoritë C3, D1, D2 dhe D3, të lidhjes nr. 9/3, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë, në masën 1% mbi pagën e pozicionit pas çdo viti pune, deri në 25 vjet.

8/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të nëpunësve të sistemit tatimor janë sipas lidhjes nr. 9/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë sipas lidhjes nr. 9/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8/6. *Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it janë sipas lidhjes nr. 9/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

8/7. *Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve në Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 9/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.*

9. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/1. Nivelet e pagave për punonjësit kërkimorë e shkencorë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët janë sipas lidhjes nr. 10/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/2. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Agjencinë e Trajtimit të Pronës janë sipas lidhjes nr. 10/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/3. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë janë sipas lidhjes nr. 10/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/4. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” (punonjësit civilë) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Akademinë e Forcave të Armatosura, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit janë sipas lidhjes nr. 10/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe vështirësi shërbimi për pozicionet civile të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “zëvendësudrejtor i përgjithshëm” në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 10/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Pozicionet në funksione operationale, operationale mbështetëse, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe organikës së kësaj agjencie.

9/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i institucionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë janë sipas lidhjes nr. 10/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/7. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i institucionit” në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor janë sipas lidhjes nr. 10/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/8. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve pa tituj akademikë në pozicionet e punës “specialist” deri në “titullar i institucionit” në Institutin e Shëndetit Publik janë sipas lidhjes nr. 10/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/9. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar dhe në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor janë sipas lidhjes nr. 10/9 (pjesët I, II dhe III), që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/10. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “ekspert” dhe “titullar i institucionit” në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes janë sipas lidhjes nr. 10/10, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9/11. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve në Qendrën Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (EIT Raw Materials Regional Innovation Centre) janë sipas lidhjes nr. 10/11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të kreut I, janë sipas lidhjes nr. 11, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike të Teatrit të Kukullave në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe të Cirkut Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 11/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/2. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura dhe trupën artistike në Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura janë sipas lidhjes nr. 11/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/3. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” (punonjës civilë) në institucionet e tjera të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të përcaktuara në shkronjën “d”, të pikës 1, të kreut I, përjashtuar Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, janë sipas lidhjes nr. 11/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/4. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Sekretar i Përgjithshëm” në administratën e prefektit janë sipas lidhjes nr. 11/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

10/5. Vlera e pagës bazë mujore për pozicionin e punës dhe shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) në sektorin e helikopterëve të Repartit Special RENEJA janë sipas lidhjes nr. 11/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11. Klasat e pagave të nëpunësve në pozicionet “specialist” deri në “titullar institucioni”, në degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 1, të kreut I dhe në Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës” të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të tujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisarate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura, janë sipas lidhjes nr. 12, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Inspektorët veterinarë kufitarë, inspektorët fitosanitarë kufitarë dhe inspektorët e shërbimit të inspektoratit ushqimor të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, të cilët bëjnë pjesë në grupet e kontrollit doganor, paguhen me klasën IV-2.

11/1. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë sipas lidhjes nr. 12/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/2. *Shfuqizuar.*

11/3. Klasat e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef sektori” në drejtoritë e policisë në qarqe, komisariate dhe reparte autonome janë sipas lidhjes nr. 12/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/4. Klasat e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i qendrës” në qendrat e mbrojtjes civile në qark janë sipas lidhjes nr. 12/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/5. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i degës” në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë sipas lidhjes nr. 12/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

11/6. Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) për pozicionet e punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i zyrës përmbartimore vendore” në zyrat përmbartimore vendore të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror janë sipas lidhjes nr. 12/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Punonjësit e projekteve, me tituj “Projekte me KfW”, “Projekti i kanalizimeve të Tiranës së Madhe”, “Projekti i shërbimeve esenciale”, në *Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës–Kanalizimeve*, deri në përfundimin e projektit përkatës të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:

a) drejtues projekti (koordinator): klasa I-4;

b) specialist: klasa IV-1.

2. Nëpunësit e Sekretariatit Kombëtar të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI – Shqipëri), të cilët, sipas organizimit të mëparshëm, kanë pasur emërtesën “koordinator” dhe një nivel page më të lartë se përcaktimi i këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë pagën që kanë pasur sipas organizimit të mëparshëm.

3. Pagat e punonjësve administrativë të institucioneve të përfshira në fushën e veprimit të këtij vendimi përcaktohen, në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës.

4. Pavarësisht kategorive të pagave të miratuara në strukturat dhe organikat ekzistuese të institucioneve, deri në miratimin e strukturave dhe organikave të reja:

a) në rastet kur në lidhjen/lidhjet që përcakton/përcaktojnë klasifikimin e pagave të institucionit, klasa e pagës për të njëjtën emërtesë është e përcaktuar vetëm me një alternativë, do të zbatohet klasa e pagës sipas përcaktimit në lidhjen/lidhjet përkatëse të këtij vendimi;

b) në rastet kur për emërtesa të njëjta në lidhjen/lidhjet, që përcakton/përcaktojnë klasifikimin e pagave të institucionit, janë përcaktuar më shumë sesa një klasë page, klasat që do të zbatohen janë si më poshtë vijon:

i. klasa II-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është II-b;

ii. klasa III-1, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-a;

iii. klasa III-2, nëse kategoria e pagës në organikën ekzistuese është III-a/1;

iv. klasa III-3, nëse kategoria e pagës për pozicionet “përgjegjës/shef sektori” në organikën ekzistuese është III-b;

v. përkatësisht klasat III-2 ose III-3, nëse kategoritë e pagave për pozicionet përgjegjës/shef sektori/zyre në organikën ekzistuese të administratës së prefektit janë përkatësisht III-b ose IV-a;

vi. përkatësisht klasat IV-1, IV-2, IV-3 ose IV-4, për të gjitha rastet e tjera, përjashtuar sa është përcaktuar më sipër në këtë pikë, nëse kategoritë e pagave në organikat ekzistuese janë, përkatësisht, III-b, IV-a, IV-b ose IV-c.

5. Vendimi nr. 187, datë 8.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohen:

a) Departamenti i Administratës Publike të mbështesë dhe të sqarojë institucionet, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e klasave të pagave deri në momentin e miratimit të strukturave dhe organikave të reja;

b)¹ institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri në datën 30 qershor 2023, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe organikat ekzistuese për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim;

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxjerrë udhëzimin përkatës për llogaritjen e pagës mujore bruto, në zbatim të këtij vendimi.

7. Efektet financiare^{2,3,4,5,6} që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 prill 2023 dhe për vitin 2023 përballohen:

a) për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, nga fondet e akorduara për këtë ministri, për këtë vit;

b) për institucionet e tjera, nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

(Ndryshuar me Vendimin nr. 421, datë 26.6.2024)

Lidhja nr. 1

¹ Vendimi nr. 421, datë 26.6.2024 botuar në F.Z. nr. 108, datë 1.7.2024 në pikën 2 të Kreut II të tij shprehet: “Institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri më 20 korrik 2024, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe në organikat ekzistuese të degëve territoriale për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim.”

² Vendimi nr.281, datë 8.5.2024 botuar në F.Z. nr.81 datë 10.5.2024, në pikën 2 të saj shprehet: “Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi:a) për përcaktimet e shkronjave “a”, “b” “c” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit/ transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;b) për përcaktimin e shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave të përcaktuara në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.”

³ Vendimi nr. 421, datë 26.6.2024 botuar në F.Z. nr. 108, datë 1.7.2024 në pikën 1 dhe 2 të Kreut III të tij shprehet: “1. Për përcaktimet e pikave 1, shkronja “b”, 4, 6 dhe 7, të kreut I, të këtij vendimi, nga data e emërimit/ transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;

